

## **RESUL TELHAJ**

### **DISA SUGJERIME PËR TRAJTIMIN E TIPAVE KUMTUESORË TË FJALIVE NË TEKSTET E GJUHËS SHQIPE**

Një nga çështjet e sintaksës që meriton vëmendje të shtuar, është edhe klasifikimi i fjalive sipas llojit të kumtimit. Në gjuhësinë shqiptare, megjithëse tradita jonë gramatikore i ka trajtuar për më se një shekull tipat e fjalive, ende hasen probleme. Problemet janë të dylojshme: probleme të numrit të kategorive që do të njihen dhe probleme të cilat lidhen me përfshirjen e një fjalie në njërin tip apo në tjetrin. Kjo problematikë është pasojë e konceptimit dhe rrjedhojë e saj terminologjia e përdorur në klasifikime e nënklasifikime, ndaj është e nevojshme që të sqarohen konceptet dhe të përdoret terminologji e qartë dhe e kuptueshme. Pasoja e moszgjidhjes së kësaj problematike gjen shfaqje në trajtimin e cunguar të tipave kumtuesorë të fjalive në tekstet shkollore dhe në vështirësitë që hasin nxënësit në kuptimin e tyre.

Duke u nisur nga dallimi thënie/fjali, do të mbështesim klasifikimin e fjalive sipas akteve të ligjërimit dhe do të përpiqemi të sqarojmë konceptet që lidhen me to. Megjithëse në literaturën gjuhësore ka mendime të ndryshme, përgjithësisht, duke lidhur çdo tip sintaksor fjalish me strukturën leksiko-gramatikore dhe një funksion të caktuar ligjërimor, dallohen *fjalitë dëftore*, *pyetëse*, *dëshirore*, *nxitëse* (*urdhërore*) e *thirrmore*. Duke krahasuar funksionin ligjërimor me semantikën dhe me gramatikën, do të argumentojmë pse duhen dalluar këta tipa në gjuhën shqipe dhe do të diskutojmë disa nënklasifikime të cilat kanë të nevojshëm përdorimin e disa termave të rinj. I gjithë synimi kryesor i këtij diskutimi është të nxisim debate dhe kërkime të mëtejshme për të zbuluar tiparet që do të ndihmonin në përcaktimin sa më të qartë të përkatësisë paradigmatisë të një fjalie, në mënyrë që të

kemi një pasqyrim sa më të plotë dhe shkencor në tekstet e arsimit parauniversitar.

### 1. Tipat e fjalive sipas llojit të kumtimit në gramatologjinë shqiptare

Klasifikimi i fjalive sipas natyrës së kumtimit që ato realizojnë, në gramatologjinë shqiptare nis që në gramatikat (sintaksa) shkollore, e përmbyllet në veprat e viteve të fundit me karakter akademik e universitar.

**Aleksandër Xhuvani** i klasifikon fjalitë në *dëftore*, *pyetëse*, *çuditëse*, *urdhënuese e dishruese*.<sup>1</sup> Pra, ai njihet pesë tipa të ndryshëm të fjalive sipas kumtimit. Ai nuk ndalet shumë në sqarimin dhe përcaktimin e tyre nga ana kuptimore, por mjafton në përcaktimin e shenjës së pikësimit që shoqëron çdo tip fjalie.

Sipas **Sheperit**<sup>2</sup>, *sipas mënyrës me të cilën e shfaqin kuptimin e tyre, fjalitë janë: a) pohore ose afirmative, kur shfaqin pohim. b) mohore ose negative, kur shfaqin mohim.. c) pyetëse, kur nuk shfaqin as pohim as mohim*. Te ky autor vihet re përfshirja e trajtës pohore e mohore në klasifikimin e fjalive, por nuk përmend fjalitë dëftore, urdhërore dhe thirrmore. Ndërsa për të fjalitë pyetëse janë një tip i veçantë.

Sipas **Justin Rrotës**<sup>3</sup> fjalia mund të jetë katër farësh, *sipas mënyrës, a trajtet, me të cilën shprehet një mendim. Në kjoftë se diftohet ky, vetëm si një kallxim, fjalia atëherë thirret: f. diftore; ne pruftë puna tue pvetun: f. pvetse; po u diftue në trajtën e njëj dishiri: f. dëshirore; si një urdhën: f. urdhërore*. Në klasifikimin e bërë nga Justin Rrota përmenden fjalitë thirrmore, apo çuditëse, siç i njihet Xhuvani, por nuk emërtohen si të tilla. Ai i njihet këto si trajta të posaçme fjalish.

<sup>1</sup> Xhuvani, A. (1938). “Njohunit e para të sintaksës shqipe, pjesa e parë”, në *Vepra I*, Tiranë, 1980, f. 206.

<sup>2</sup> Sheperi, I. D. (1927). *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe (sidomos e toskërishtes)*. Vlorë: Shtypshkronja “Vlora” G. Direttore & C., f. 177.

<sup>3</sup> Rrota, J. (2005). *Sintaksi i shqipes*. Shkodër: Botime Franceskane, f. 6.

**Kostaq Cipo**<sup>4</sup>, është autori që në sintaksën e tij njeh 6 tipa fjalish, të cilat ai i emërton fjali të pavarura. Për të *farët e fjalive të pavarura janë: lëçitëse, urdhëronjëse e pyetëse, eksklamative, hipotetike, kundërshtore*. Për fjalitë *lëçitëse* sot përdoret emërtimi *fjali dëftore*, ndërsa fjalia *eksklamative* quhet *thirrmore*. Cipo i njeh fjalitë thirrmore si tip i veçantë. Për të *fjali eksklamative është ajo që shpreh një ndjenjë të papritur*.<sup>5</sup> Fjalitë dëshirore i përfshin në grupin e fjalive urdhërore. Fjali *hipotetike* do të ishte një fjali e pavarur që do të shprehte një ide të supozuar, por një tip i tillë fjalie nuk është njohur më pas në gramatikat tona. Si fjali të pavarur Cipo njeh edhe fjalinë *kundërshtore*. *Fjalia kundërshtore është ajo që shfaq kuptim të kundërt me domethëniën e fjalisë me të cilën është renditur*.<sup>6</sup> Pra, si fjali kundërshtore njihet fjalia me bashkërenditje kundërshtore. Po ashtu te ky klasifikim, duke qenë se niset nga kriteri i të qenit të pavarura, Cipo përfshin edhe fjalinë *ndërmjetëse* dhe fjalinë *sqaruese*.

Gjithashtu për këtë autor e rëndësishme është të thuhet se ai dallon, edhe nga pikëpamja terminologjike, dy klasifikime të ndryshme të fjalive. Ai me termin *farët e fjalive të pavarura*, emërton fjalitë e thjeshta të para përgjithësisht nga vlera që ato marrin në ligjërim, ndërsa me termin *trajtë* emërton mënyrën se si ato e shfaqin këtë vlerë, duke dalluar trajtën *pohore, mohore* dhe *pyetëse*. Ai shprehet: *Fjalia, po të vështrohet nga një pikëpamje e përgjithshme, mund të marrë këto tri trajta: 1. trajtën pohore, 2. trajtën mohore dhe 3. trajtën pyetëse*.<sup>7</sup> Trajtën pyetëse të fjalisë ky autor herë e sheh si “farë” e herë si “trajtë”. Pra, për të fjalia pyetëse është edhe njësi e mëvetësishme, e pavarur, edhe njësi e cila hyn në kundërvënie me trajtën pohore e mohore.

Për klasifikimin e fjalive të thjeshta **Stefan Prifti** bazohet në mënyrën se si e shprehim mendimin me anë të tyre. Ai dallon fjali *gjykimi, pyetëse, dëshirore, habitore ose thirrrore*.<sup>8</sup> Me fjali gjykimi ai

<sup>4</sup> Cipo, K. (1952). *Sintaksa*. Tiranë: N.I.SH. Shtypshkronjave-Stab. Mihal Duri, f. 6.

<sup>5</sup> *Po aty*, f. 6.

<sup>6</sup> *Po aty*, f. 6.

<sup>7</sup> *Po aty*, f. 6.

<sup>8</sup> Prifti, S. (1958). *Sintaksa e gjuhës shqipe*. Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore të krahinës socialiste autonome të Kosovës, f. 43.

emërton fjalitë dëftore dhe dallon fjalitë e gjykimit pohonjës dhe fjalitë e gjykimit mohonjës. Fjalitë dëshirore i ndan në katër lloje: a. fjali thjesht dëshirore. *Kjo është fjali e kulluar dëshirore që shpreh format kryesore të dëshirave tona pasive, siç janë urimi dhe mallkimi.*<sup>9</sup>; b. fjali dëshirore urdhërore. *Fjalìa dëshirore quhet urdhërore kur i shpreh dëshirat në formën e urdhrit, d.m.th., në formën e kërkesës së theksuar, e cila, për folësin duhet të shpiket patjetër në fund, të realizohet.*<sup>10</sup>; c. fjalìa dëshirore nxitëse. *Është fjalìa, kur folësi dëshirat e tij i shpreh në formën e nxitjes apo këshillës, d.m.th, me qëllim për nxitje apo këshillë.*<sup>11</sup> ç. fjalìa dëshirore e lejimit dhe e lutjes. *Dëshira mund të shprehet edhe në formë lejimi apo pëlqimi, si edhe në formë lutjeje.*<sup>12</sup> Ky autor njih edhe fjalitë habitore si një tip më vete dhe për to shprehet: *Fjalìa habitore është ajo që shpreh mendimin e folësit të shoqëruar me ndjenja të fuqishme ose të papritura, si çudi, admirim, habi etj.*<sup>13</sup>

**M. Domi** shprehet se “*Fjalìa mund të ketë kuptime e trajta të ndryshme dhe lidhur me këto merr emra të ndryshëm. Ajo mund të jetë: dëftore, kur kumton, bën të njohur diçka; pyetëse, kur pyet për diçka; urdhërore, kur çfaq vullnetin e folësit; dëshirore, kur shpreh një dëshirë të tij që s’varet nga ai. Kur tregimi i një gjëje, shprehja e një urdhëri, e një dëshire, e një pyetjeje, shoqërohet edhe me shprehjen e dukshme të një ndjesie të folësit, atëherë fjalìa është këlthitëse.*”<sup>14</sup> Pra, Domi njih katër tipa kryesor të fjalive sipas natyrës së kumtimit, ndërsa thirrmoret ai nuk i sheh si një lloj i veçantë, por si një karakteristikë e mbishtuar e këtyre katër tipave kryesore dhe i emërton me termin *këlthitëse*, term ky që nuk ka gjetur përdorim në gramatologjinë shqiptare.

Një tjetër klasifikim për tipat e fjalive gjejmë në Gramatikën e Akademisë. Sipas GA dallohen, në bazë të llojit të kumtimit, të natyrës së përmbajtjes, të rolit, funksionit që përmbushin në ligjëratë,

<sup>9</sup> *Po aty*, f. 45.

<sup>10</sup> *Po aty*, f. 46.

<sup>11</sup> *Po aty*, f. 46.

<sup>12</sup> *Po aty*, f. 47

<sup>13</sup> *Po aty*, f. 47.

<sup>14</sup> Domi, M. (1969). *Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa*. Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore, f. 6.

tri grupe të mëdha, tre tipa fjalish: 1. *fjalitë dëftore*; 2. *fjalitë nxitëse e dëshirore*; 3. *fjalitë pyetëse ose fjalitë e pyetjes*.<sup>15</sup> Siç shihet, në këtë vepër fjalitë nxitëse e dëshirore përfshihen në një grupim, ndërsa nuk njihen si tip i veçantë fjalitë thirrmore, por natyrën thirrmore ua njeh të tre tipave të fjalive. Sipas kësaj gramatike fjalitë mund të shprehin, përveç njoftimit të diçkaje, dëshirës a nxitjes për veprim, pyetjes, edhe qëndrimin ndjesor të folësit ndaj asaj që thotë, ndjenjat që ngjall kjo tek ai. Secili tip i fjalive – dëftore, dëshirore, nxitëse, pyetëse – mund të dalë, kështu, edhe në formën e një fjali të shqiptuar me një intonacion të ndieshëm ngashërimor, thirrmore, e atëherë është *fjali thirrmore*. Kemi kështu, *fjalitë dëftore-thirrmore*, *fjalitë dëshirore-thirrmore* e *nxitëse-thirrmore*, *fjalitë pyetëse thirrmore*.<sup>16</sup>

Qëndrim të ndryshëm nga GA mban M. Çeliku në veprën e tij “Sintaksë e Gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)”. Për të, *sipas qëllimit të thënies dhe intonacionit të tyre karakteristik, fjalitë e thjeshta ndahen në pesë grupe: 1. dëftore; 2. pyetëse; 3. urdhërore; 4. dëshirore; 5. thirrmore*.<sup>17</sup> Ndryshe nga autorët e tjerë, të cilët mbajnë natyrën e kumtimit si kriterin kryesor të klasifikimit të fjalive, Çeliku si kriter primar mban qëllimin e thënies, duke qenë se fjalinë e sheh si pasqyrë të një thënieje konkrete, ndërsa përfshin si kriter edhe intonacionin e veçantë karakteristik për secilin tip. Këto dy tipare, si edhe tiparet strukturore të ndryshme që shfaqin tipat e fjalive të thjeshta në gjuhën shqipe janë argumentet mbi të cilat ky autor mbështet klasifikimin e mësipërm duke njohur edhe fjalitë thirrmore si një tip i veçantë fjalish. “*Secili tip përbën një konstrukt të veçantë më vete e dallohet jo vetëm nga përmbajtja kumtuese e funksioni, por edhe nga ndërtimi leksiko-gramatikor si edhe nga intonacioni i veçantë*.”<sup>18</sup> Gjithashtu Çeliku për fjalitë e njohura nga GA dhe tekstet shkollore si *nxitëse*, në këtë vepër ndërron mendim dhe përdor termin *urdhërore*.

<sup>15</sup> ASHSH. (2002). Gramatika e gjuhës shqipe (Vol. Sintaksa). Tiranë: Maluka, f. 117.

<sup>16</sup> *Po aty*, f. 118.

<sup>17</sup> Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*. Tiranë: ILAR, f. 278.

<sup>18</sup> Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*. Tiranë: ILAR, f. 279.

Megjithëse tradita jonë gramatikore i ka trajtuar për më se një shekull tipat e fjalive, ende hasen probleme. Problemet janë të dylojshme: **probleme të numrit të kategorive që do të njihen dhe probleme të cilat lidhen me përfshirjen e një fjalie në njërin tip apo në tjetrin.**

Kështu, siç e kemi përmendur më sipër, Gramatika e Akademisë përcakton tre grupe kryesore dhe katër tipa. Ndërsa, Çeliku njuh pesë tipa fjalish, duke i quajtur si tip më vete fjalitë thirrmore. Autorë të tjerë i përfshijnë kategori të caktuara si nënloje të një kategorie më të madhe etj. Klasa e fjalive *dëftore* dhe *pyetëse* shfaqen si klasa për të cilat nuk ka kundërshti në ekzistencën e tyre. Ndërsa klasa e fjalive dëshirore, urdhërore (nxitëse) e thirrmore janë ato të cilat, herë njihen si të veçanta, herë përfshihen në një grup e herë shihen si nënkategori të një grupi të caktuar.

Për sa i përket problemit të dytë, problemit të përfshirjes së një fjalie në këtë apo atë tip të caktuar, ky është një problem që lidhet me kriterin bazë të klasifikimit. Kështu në GA thuhet: *ka fjali pyetëse nga forma (zakonisht me intonacion pyetës, herë-herë edhe me fjalë pyetëse) me të cilat nuk pyetet për diçka, po pohohet a mohohet me një forcë të veçantë, ose shprehet nxitje për një veprim.*<sup>19</sup> Pra, po të nisemi nga forma janë fjali pyetëse, po të nisemi nga funksioni janë pohime, urdhra etj.

Rrjedhimin e këtyre qëndrimeve jo të prera dhe të diskutueshme e hasim të pasqyruar edhe në tekstet e gjuhës shqipe në arsimin parauniversitar.

## **2. Përshkrimet e tipave kumtuesorë të fjalive në tekstet e arsimit parauniversitar**

Nga vëzhgimi i teksteve të gjuhës shqipe të arsimit parauniversitar (Gjuha shqipe 6, 7, 8, 9, botuar nga shtëpia botuese Albas, 2018), tipat e fjalive sipas kumtimit që shprehin, trajtohen si tema të veçanta vetëm në tekstin e klasës së 9, në dy tema: një temë për *fjalitë dëftore e pyetëse* dhe një për *fjalitë nxitëse e dëshirore*. Ndërsa, sipas kurrikulës bërthamë të gjuhës shqipe për arsimin e

---

<sup>19</sup> ASHSH. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe* (Vol. Sintaksa). Tiranë: Maluka, f. 119.

mesëm të lartë, klasifikimi i fjalive sipas llojit të kumtimit nuk rimerret e nuk zgjerohet më tej. Kjo gjë mendojmëse rrjedh edhe për arsye se edhe në gramatikat e shqipes, trajtimi i tipave kumtesorë të fjalive është jo i plotë dhe jo shterues.

Siç mund të kuptohet edhe nga temat e mësimëve, dallohen vetëm 4 tipa kumtesorë të fjalive: *fjalìa dëftore*, *fjalìa pyetëse*, *fjalìa nxitëse* dhe *fjalìa dëshirore*. Fjalitë thirrmore, ashtu si edhe në GA, shihen si variante të këtyre 4 tipave dhe për rrjedhojë kemi: *fjalìa dëftore-thirrmore*, *fjalìa pyetëse-thirrmore*, *fjalìa nxitëse-thirrmore* e *fjalìa dëshirore-thirrmore*.<sup>20</sup>

Si kriteret e klasifikimit të fjalive shërbejnë natyra e kumtimit që realizohet, dhe tiparet formale më të përgjithshme që shfaqen. Natyra e kumtimit përcaktohet mbi bazë të aktit të përgjithshëm që realizohet. Kështu fjalitë dëftore dallohen kuptimisht sepse me anë të tyre shprehet *diçka që ka ndodhur, ndodh apo do të ndodhë dhe që folësi e paraqet si të vërtetë. Me anë të tyre: pohojmë ose mohojmë diçka; shprehim mendimet ose gjykimet tona; shprehim një mundësi, supozim a domosdoshmëri etj.*<sup>21</sup> Me anë të fjalive pyetëse folësi kërkon të mësojë diçka që është e panjohur për të, ose për të cilën është i pasigurt.<sup>22</sup> Fjalitë nxitëse e dëshirore shprehin vullnetin e folësit në formë dëshire ose kërkesë për t'u realizuar një veprim ose jo. Me anë të fjalive nxitëse folësi nxit dëgjuesin a dëgjuesit të bëjnë diçka në formën eurdhrit të prerë, të këshillës, porosisë, kërkesës, lutjes etj. Me anë të fjalive dëshirore folësi shpreh një dëshirë në formë urimi, përhëndetjeje, betimi, mallkimi a sharjeje.

Si tipare morfo-sintaksore dalluese për klasifikimin e fjalive shërbejnë përgjithësisht: *mënyra e foljes, intonacioni dhe rendi i përbërësve*.

Kështu fjalitë dëftore dallohen nga folja në dëftore, e cila mund të jetë edhe në mënyrën habitore a kushtore, ose kur fjalìa është e varur edhe në lidhore, intonacioni zbritës dhe rendi i drejtë i njëjësive: kryefjalë + kallëzues + kundrinor + rrethanor.

<sup>20</sup> Petro, R., Sula, L., Jubani, A., Metani, I., Çerpja, A., Çepani, A., *Gjuha shqipe* 9, Albas, Tiranë, 2018, f. 248.

<sup>21</sup> *Po aty*, f. 248.

<sup>22</sup> *Po aty*, f. 249.

Fjalia pyetëse dallohet nga: intonacioni, fjalët pyetëse (përemra, ndajfolje, pjesëza) dhe rendi i fjalëve.

Fjalia nxitëse dallohet nga intonacioni i veçantë dhe mënyra urdhërore, mënyra lidhore ose e tashme dhe e ardhme e dëftores e foljes-kallëzues.

Fjalia dëshirore dallohet nga mënyra *dëshirore* ose *lidhore* e foljes.

Rrafshi në të cilin bazohet ky klasifikim nuk është i qartë, sepse nga njëra anë përshkruhet forma e njësisë, nga ana tjetër kuptimi i përgjithshëm i njësisë. Pra, herë fjalia shihet si njësi e gjuhës e herë si njësi e ligjërimit. Ky qëndrim jo i drejtë është edhe në pohimin: “Fjalia është njësia më e vogël e ligjërimit. Ajo përbëhet nga një a më shumë fjalë, të cilat kumtojnë të dhëna, mendime, ndjenja, dëshira, pyetje etj.”<sup>23</sup> që gjendet në tekstin e klasës së gjashtë si përkufizim për fjalinë, ku fjalia shihet si njësi e ligjërimit dhe jo si njësi e gjuhës.

Ky qëndrim vjen si pasojë e mosmarrjes në konsideratë saç duhet të dallimit gjuhë/ligjërimit dhe dallimit midis njësive të gjuhës (fjalisë) dhe njësive të ligjërimit (thënies).

### 3. Fjalia dhe thënia

Dikotomia *gjuhë/ligjërimit* e propozuar nga Sosyri çoi në dallimin dhe përcaktimin e njësive të gjuhës dhe njësive të ligjërimit. Vëmendja më e madhe e gjuhëtarëve iu kushtua gjuhës, dhe u përcaktuan e u analizuan thuajse në mënyrë shteruese njësitë e gjuhës, duke i lënë elementet e ligjërimit si të dorës së dytë. Vetëm në gjysmën e dytë të shek. XX nisi të ndryshonte kah interesimi i gjuhëtarëve duke u drejtuar nga ligjërimit dhe nisën të përcaktohen e studiohen njësitë e ligjërimit. Si njësi të ligjërimit njihen: *thënia, grupi kuptimor, fjala fonetike, rrokja dhe tingulli*<sup>24</sup>.

De Mauro shprehet se vetë Sosyri nuk mban qëndrim të qartë nëse fjalia është njësi e gjuhës apo e ligjërimit.<sup>25</sup> Në veprën e tij “Kurs

<sup>23</sup> Petro, R., Sula, L., Pepivani, N., Çerpja, A., Jubani, A., Metani, I., *Gjuha shqipe* 6, Albas,Tiranë, 2015, f. 229.

<sup>24</sup> Memushaj, R. (2002). *Hyrje në gjuhësi*. Tiranë: DITURIA. f. 55.

<sup>25</sup> Graffi, G. (2001). *200 years of Syntax: A critical survey*. Amsterdam: John Benjamin Publishing Company, f. 170.

i gjuhësisë së përgjithshme” ai fjalinë e sheh si njësi të ligjërimit<sup>26</sup>, ndërsa sintagmat që e përbëjnë atë si njësi të gjuhës. Dallimi fjali/thënie nisi të nxjerrë krye që në veprat e ndikuara nga gjuhësia strukturaliste. Disa gjuhëtarë strukturalistë përzgjedhin thënien dhe jo fjalinë si njësinë fillestare për analizat dhe klasifikimet e njësive sintaksore.<sup>27</sup> Me gjithë luhatjet e autorëve të caktuar, përgjithësisht në mendimin gjuhësor botëror pranohet se *fjalìa* është njësi e gjuhës, ndërsa *thënia* është njësi e ligjërimit. Si pjesëmarrës në aktet e të folurit, ne u kumtojmë të tjerëve idetë, mendimet dhe emocionet tona. Këtë e bëjmë me anën e *thënieve*, të cilat janë njësia themelore e ligjërimit me funksion kumtues.<sup>28</sup>

*Çfarë është thënia? Ku dallon thënia nga fjalìa?* Thënia është njësia më e vogël e të thënit, prodhim gjuhësor, fryt i operacioneve thënësore e predikative të kryera nga thënësi.<sup>29</sup> Pra, thënia është një njësi konkrete e ligjërimit të një thënësi konkret, në një kohë dhe në një vend të caktuar. Ajo shfaqet si rezultat i të thënit, i cili është procesi krijues që mundësitë që jep gjuha i kthen në thënie, në ligjëratë.<sup>30</sup> Thënia është rezultat (prodhim) i kompetencës gjuhësore të një njeriu në një situatë ligjërimore të caktuar. Ajo lidhet drejtpërdrejt me performancën si shfaqja konkrete e aftësisë gjuhësore të një njeriu në ligjërim.

Ligjërimi, përveç funksionit të vet themelor që është transmetimi i përmbajtjeve, ka edhe funksione të tjera; ai është gjithashtu *veprim*.<sup>31</sup> Çdo thënie jo vetëm transmeton një përmbajtje të caktuar, por kryen edhe një lloj *akti ligjërimor* ndaj bashkëfolësit të vet duke premtuar, pyetur, kërcënuar etj. Thëniet janë të pajisura me një forcë shprehëse (illocutoire) që mund të qartësohet nga sintaksa, intonacioni ose konteksti.<sup>32</sup>

---

<sup>26</sup> De Saussure, F. (2002). *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*. (R. Ismajli, Përkth.) Tiranë: DITURIA. f. 143.

<sup>27</sup> Graffi, G. (2001). *200 years of Syntax: A critical survey*. Amsterdam: John Benjamin Publishing Company, f. 233.

<sup>28</sup> Memushaj, R. (2002). *Hyrje në gjuhësi*. Tiranë: DITURIA. f. 54.

<sup>29</sup> Përnaska, R. (2015). *Gjuhësi... gjuhësore*. Tiranë: Maluka, f. 151.

<sup>30</sup> *Po aty*, f. 157.

<sup>31</sup> *Po aty*, f. 166.

<sup>32</sup> *Po aty*, f. 167.

Ndërsa fjalia është njësi abstrakte, njësi e gjuhës e cila ndërtohet mbi bazë të rregullave të caktuara gramatikore që veprojnë në gjuhë të ndryshme në mënyra të ndryshme. *Fjalia ka skemë të vet ndërtimore, madje disa skema, ka formulën e vet. ... skemat ndërtimore të fjalisë i përkasin sistemit gjuhësor në tërësi.*<sup>33</sup> Skemat ndërtimore të fjalisë kanë karakter abstrakt dhe shërbejnë si modele të caktuara (të gatshme). Mbi bazë të këtyre modeleve ndërtohen një numër i pafundmë fjalish. Këto skema, në studimet sintaksore të fundit pasqyrohen edhe në mënyrë grafike, skema e drurit, skema e kllapave apo *pasqyra e pluseve*.<sup>34</sup> Fjalitë e një gjuhe hyjnë në raporte asociative (paradigmatike), pra, mund të klasifikohen në gjedhe të caktuara duke u nisur nga ndërtimi i tyre strukturor.

Sipas Çelikut, fjalia e thënia nuk përputhen plotësisht; ato përputhen pjesërisht, kur fjalia përdoret si akt ligjërimit, si instrument komunikimi.<sup>35</sup> Për të një fjali është potencialisht një thënie ose më shumë se një thënie dhe realizohet si e tillë në momentin që përdoret në ligjërimin e gjallë. Intonacioni dhe rrethana ligjërimore janë dy elemente që ndihmojnë realizimin e thëniesve të ndryshme nga e njëjta fjali. Sipas Lloshit, thënia është një fjali plus konteksti i përdorimit të saj.<sup>36</sup> Konteksti u jep thëniesve tona kuptimin real. Nëse një thënie e shkëpusim nga konteksti, pra e shohim si fjali, mund të vëmë re se do të dukej pa kuptim. Megjithatë, duhet të kemi parasysh se kemi veçmas *kuptimit të fjalisë*, dhe dy kuptime të tjera, *kuptimin e thënies* dhe *kuptimin e folës/dëgjuesit*.<sup>37</sup> Pra, është e rëndësishme të dallohet kuptimi i fjalive nga domethënia e thëniesve.

<sup>33</sup> *Po aty*, f. 124.

<sup>34</sup> Pasqyra e pluseve është një skemë e propozuar nga M. Çeliku në veprën “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë). Kjo skemë mbart në vetvete origjinalitet sepse mëton t’i shpjegojë lidhjet strukturore hierarkike të njësive përbërëse të fjalisë në skaje terminologjike të shqipes, duke u bazuar në lidhjet dyshe të këtyre elementeve.

<sup>35</sup> Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*. Tiranë: ILAR, f. 33.

<sup>36</sup> Lloshi, Xh. (2005). *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*. Tiranë: Albas, f. 296.

<sup>37</sup> Lloshi, Xh. (2005). *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*. Tiranë: Albas, f. 298.

Çeliku shprehet se “Në sintaksën tradicionale fjalia konsiderohet njëherazi njësi kumtuuese, ndërtimore dhe intonacionore, duke e konceptuar kështu jo vetëm si diçka abstrakte, por edhe si njësi funksionale, kumtuuese dhe intonacionore e gjuhës.”<sup>38</sup> Edhe për Përnaskën “në traditën tonë gramatikore nuk është trajtuar thënia si njësi kumtuuese. Si njësi kumtuuese është mbajtur vetëm fjalia dhe periudha a fjalia e përbërë... Vetëm rrallë, e në raste të caktuara, është bërë dallimi thënie/fjali, si, p.sh., kur është folur për rendin e gjymtyrëve.”<sup>39</sup> Për të thënia nuk është e njëjtë me fjalinë, sepse ekzistojnë njësi gjuhësore që në ligjërime shërbejnë si thënie, ndërsa nuk plotësojnë strukturën minimale të një fjalie.

Trajtimi i fjalisë si thënie, duke mos i dalluar si njësi të dy rrafshëve të ndryshëm, rrafshit thjesht gjuhësor (abstrakt) dhe rrafshit funksional, ka bërë që në disa klasifikime e nënklasifikime për tipat e fjalive të përdoren kriteret funksionale e në disa të tjera të përdoren kriteret formale-gramatikore, ose gërshetime kriteresh. Është e rëndësishme që të ruajmë dallimet midis dy rrafshëve, të përcaktojmë njësitë dhe llojet e nënllojet e tyre sipas rrafshëve përkatëse dhe jo duke i gërshetuar tiparet e njërit rrafsh me tiparet e rrafshit tjetër.

#### 4. Tipat e fjalive dhe aktet e ligjërimit

Në kontrast me pikëpamjen tradicionale se funksioni i gjuhës është vetëm përshkrues, tani është gjerësisht e pranuar se kur flasim në realizojmë veprime të llojeve të ndryshme.<sup>40</sup> Filozofi John Austin (1911-1960) e cilëson idenë se ligjërime është i lidhur me realitetin dhe mundëson përshkrimin e tij, *iluzion deskriptiv*.<sup>41</sup> Sipas Austinit disa thënie shërbejnë për të përshkruar botën (a), disa të tjera kanë tjetër funksion. Ato shërbejnë për të bërë diçka: të bëjnë një pyetje (b), të bëjnë një premtim (c) dhe të japin një urdhër (d).

<sup>38</sup> Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*. Tiranë: ILAR, f. 35.

<sup>39</sup> Përnaska, R. (2015). *Gjuhësi... gjuhësore*. Tiranë: Maluka, f. 169-170.

<sup>40</sup> König, E., & Siemund, P. (2007). *Speech act distinctions in grammar*. Në T. Shopen, *Language typology and syntactic description* (fv. 276-324). New York: Cambridge University Press, f. 276.

<sup>41</sup> Plangarica, T. (2013). *Hyrje në studimin e kuptimit*. Elbasan: Cikël leksionesh, f. 17.

(1)

- a. *Toka rrotullohet rreth Diellit.*
- b. *Kush mungon sot?*
- c. *Të premtoj se do të vij.*
- d. *Shko shpejt në punë!*

Ky autor i ndan thëniet që shërbejnë për të përshkruar botën, të cilat i quan *thënie konstatauese*, nga thëniet që shërbejnë për të realizuar një veprim, të cilat i quan *thënie performative*.<sup>42</sup> Austini ka propozuar një tezë sipas së cilës thëniet realizojnë tri tipe të akteve të ligjërimit: një *akt lokucionar* – fakti i të thënit të diçkaje, një fjali gramatikore me një kuptim dhe një referencë, - një *akt ilokucionar*, të realizuar duke thënë diçka, si të pohosh/afirmosh, të pyesësh, të premtosh, të urdhërosh, të falënderosh, të vësh një bast etj. – dhe një *akt perlokucionar*, të realizuar nga fakti i të thënit të diçkaje, si të bindësh, ta bësh tjetrin të të besojë, të kërcënoh, t'i shtiesh frikën tjetrit.<sup>43</sup>

Teoria e akteve të ligjërimit u zhvillua më tej nga John Searle. Ai u shpreh qartë se ekziston një dallim i fortë midis përmbajtjes së fjalisë dhe forcës së shprehjes dhe e bazon analizën e tij në një këndvështrim mentalist, në të cilin përfshin qëllimet e folësit dhe njohjen e tyre.<sup>44</sup> Sipas Searleit, një njeri mund të realizojë një akt ligjërimit nëse ai ka për qëllim që ta bëjë atë, duke përdorur një tip të caktuar fjalie, dhe nëse ekziston qëllimi i dikujt tjetër për të marrë (kuptuar) qëllimin e tij. Ai ka propozuar një seri rregullash konvencionale që duhet të respektohen në mënyrë që një akt ilokucionar të kurorëzohet me sukses. Fillimisht ka *rregulla paraprake* që mbështeten në situatën e komunikimit, veçanërisht në faktin që folësit duhet të flasin të njëjtën gjuhë, dhe në bindjet e planit të dytë të folësit. Në vijim *rregulla e brendisë* a e *informacionit propozicional* (të fjalisë) që përcakton brendinë a informacionin semantik të aktit ligjërimit. *Rregulla e sinqeritetit* që specifikon gjendjen mendore të folësit. Më së fundi, *rregulla thelbësore* që përcakton tipin e detyrimit të vënë nga njëri ose tjetri prej

---

<sup>42</sup> *Po aty*, f. 17.

<sup>43</sup> *Po aty*, f. 18.

<sup>44</sup> Ambroise, B. (2010). *From speech act theory to pragmatics*. HAL, f. 5.

bashkëbiseduesve.<sup>45</sup> Searlei dallon pesë tipa kryesorë të akteve ligjërimore: përfaqësues, urdhërues, deklarues, udhëzues dhe shprehës.<sup>46</sup> Funktionalisti Halliday njuh katër tipa kryesor të funksioneve të ligjërimin, *offer* (ofertë), *komandë*, *pohim*, dhe *pyetje*.<sup>47</sup> Megjithëse autorë të ndryshëm njohin akte të ndryshme ligjërimore, ata afrojnë në atë se të gjithë i njohin funksionet kryesore që realizohen në ligjërim: *dëftimi*, *pyetja*, *urdhri*, *dëshira*, *eksklamacioni* (shprehja e ndjenjave).

Elementet që ndikojnë në përcaktimin e tipit të aktit të realizuar në prodhimin e një thënieje quhen “tregues të forcës së shprehjes”. Me këtë term u referohet elementëve gramatikorë dhe aplikimit të tyre në kontekste të ndryshme. Elementet që mund të shfaqen në nivele të ndryshme të strukturës gjuhësore, përfshijnë:

a. Karakteristika të strukturës morfo-fonologjike e morfo-sintaksore

b. Karakteristika të organizimit leksikor

Disa nga tiparet të cilat kontribuojnë në përcaktimin e llojit të aktit ligjërimor që përmbush ai që flet, janë të kodifikuar në strukturën gramatikore të thënies. Këta tregues gramatikorë janë: *intonacioni*, *mënyra dhe koha e foljes*, *pjesëzat klitike e enklitike*, *përemrat*, *ndajfoljet*, *mbiemrat*, *lidhëzorët (konektorët)*, *struktura e leksikut*.<sup>48</sup> Nuk ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet treguesve gramatikorë dhe tipit të aktit të ligjërimin. Forca shprehëse e një thënieje është rezultat i ndërveprimit të treguesve gramatikorë dhe informacionit kontekstual, ndërmjet këtyre dy aspekteve mund të ketë edhe mospërputhje. Në shumicën e rasteve lloji i aktit të ligjërimin varet nga konteksti.<sup>49</sup>

---

<sup>45</sup> Plangarica, T. (2013). *Hyrje në studimin e kuptimit*. Elbasan: Cikël leksionesh, f. 79.

<sup>46</sup> Konig, E., & Siemund, P. (2007). Speech act distinctions in grammar. Në T. Shopen, *Language typology and syntactic description* (fv. 276-324). New York: Cambridge University Press, f. 278.

<sup>47</sup> Halliday, M. (2004). *An introduction to functional grammar*. New York: Oxford University Press, f. 108.

<sup>48</sup> Renzi, L., Salvi, G., & Cardinaletti, A. (2001). *Grande grammatica italiana di consultazione* (Vëll. i III). Bologna: il Mulino, f. 23.

<sup>49</sup> *Po aty*, f. 25.

Edhe pse jo gjithmonë akti ligjërimor është i lidhur me mjetet gjuhësore, në shumicën e rasteve janë mjetet gjuhësore ato që ndikojnë në realizimin e tij. Realizimi i aktit ligjërimor e gjen shprehjen edhe në tipat e fjalive. Tre tipa kryesorë të fjalive janë dalluar në gjuhët e Europës dhe gjithashtu janë parë si të përdorshme edhe në klasifikimet për shumë gjuhë të tjera: *dëftore*, *urdhërore* dhe *pyetëse*.<sup>50</sup> Këta tre tipa lidhen edhe me tre kategori kryesore të forcës së shprehjes, *pohimit*, *urdhrit* dhe *pyetjes*.<sup>51</sup> Fjalitë dëftore përdoren përgjithësisht dhe në të shumtën e rasteve për akte ligjërimore, si: pohim, pretendim, konstatim, por gjithashtu edhe akuzim, kritikë, premtim dhe garantim. Fjalitë pyetëse përdoren në aktet e kërkimit të informacionit, të pyeturit, shqyrtimit etj., ndërsa fjalitë urdhërore përdoren që të urdhërojnë ose këshillojnë dëguesin për të bërë diçka, në akte të këtilla, si urdhër, komandë, sugjerim, rekomandim, lutje etj. Megjithatë, nuk kemi një përputhje të plotë ndërmjet tipeve të akteve të ligjërimit me tipet sintaksore të fjalive. Mund të ndodhë që e njëjta thënie të përdoret për të përmbushur akte ligjërimore të ndryshme. Dhe anasjelltas, thënie të tipave të ndryshëm sintaksorë mund të përfaqësojnë të njëjtin akt ligjërimor, kështu që folësi (thënësi) mund të përdorë njërin ose tjetrën.<sup>52</sup>

Pavarësisht vështirësive që hasen në përcaktimin e tipave të fjalive, një klasifikim i tyre është i mundshëm. Duke pasur parasysh se “*forca e shprehjes është një tipar i thënieve: është akti i të thënit të një fjalie ai që mbart forcë shprehjeje, jo vetë fjalia*”<sup>53</sup>, për përcaktimin e tipave kryesorë të fjalive duhet që të merren parasysh kriteret gramatikore formale. Tiparet formale që duhet të dallojnë tipat e fjalive duhet të përcaktohen si të tillë duke i parë si elemente që formojnë një sistem, ku një karakteristikë formale e një tipi fjalie t’i përkasë vetëm atij tipi dhe asnjë fjali të mos i përkasë më shumë se një

<sup>50</sup> Konig, E., & Siemund, P. (2007). Speech act distinctions in grammar. Në T. Shopen, *Language typology and syntactic description* (fv. 276-324). New York: Cambridge University Press, f. 277.

<sup>51</sup> Huddleston, R., & Pullum, G. K. (2002). *The Cambridge Grammar of the English Language*. Cambridge, UK: Cambridge University Press., f. 858.

<sup>52</sup> Renzi, L., Salvi, G., & Cardinaletti, A. (2001). *Grande grammatica italiana di consultazione* (Vëll. III). Bologna: il Mulino, f. 43.

<sup>53</sup> Hudson, R. (1975). The meaning of questions. *Language*, 51 (1), f. 4.

tipi.<sup>54</sup> Megjithëse këto tipare janë heterogjene, ato duhet të vlejnë në mënyrë që një fjali të një gjuhe të caktuar të klasifikohet sipas një kategorie kryesore.

## **5. Sugjerime për trajtimin e tipave kumtesorë të fjalive në tekstet e gjuhës**

Duke u mbështetur në parashtrimet e mësipërme teorike dhe në konstatimet e nxjerra nga vështrimi i tipave kumtesorë të fjalive në gramatikat e shqipes, po japim disa sugjerime, të cilat mendojmë se duhet të merren parasysh, si në hartimin e teksteve të arsimit parauniversitar, ashtu edhe në hartimin e teksteve universitare. Edhe pse është e nevojshme që të ndërmerren studime për secilin tip të fjalive në veçanti, në monografi të veçanta, për të analizuar tiparet gjuhësore dhe funksionet ligjërimore të secilit tip fjalie.

Si sugjerime kryesore për trajtimin e tipave kumtesorë të fjalive në tekstet e arsimit parauniversitar, por edhe atyre universitar, dalin këto:

### **1. Përshkrimi i rrafsheve të përgjithshme të interpretimit**

Mendojmë se në tekste duhet të përshkruhen me gjuhë të kuptueshme për nxënësit të tre rrafshet për të bërë të qartë pikëtakimet dhe dallimet e secilit prej tyre. Duke i parë tipat e fjalive si ndërlidhje e tre faktorëve kryesorë: kuptimit të përgjithshëm, tipareve gramatikore dhe akteve ligjërimore përfaqësuese të cilat realizohen me këto mjete gjuhësore dhe duke ruajtur qartë dallimet e secilit rrafsh, do të bëheje mundur që klasifikimi i tipave të fjalisë të bëhej duke u bazuar në kritere të qarta dhe do të ishte, sipas mendimit tonë, më i plotë e më i qartë.

### **2. Përdorimi i terminologjisë specifike për të ruajtur dallimet midis rrafsheve**

Mendojmëse është e nevojshme të përdorim terma të ndryshëm për secilin rrafsh, p.sh., *pyetje* për të shënuar njësinë në pikëpamje semantike, *fjali pyetëse* për të shënuar njësinë si kategori sintaksore

---

<sup>54</sup> Konig, E., & Siemund, P. (2007). Speech act distinctions in grammar. Në T. Shopen, *Language typology and syntactic description* (fv. 276-324). New York: Cambridge University Press, f. 278.

dhe të pyeturit për të shënuar aktin e ligjërimit. Po ashtu edhe në nënklasifikime të përdoren terma sipas rrafshit. Kështu, në nënklasifikimin e fjalive pyetëse e fjalive nxitëse të mos përdoret përcaktori *i mirëfilltë/jo i mirëfilltë*, kur ky nënklasifikim i referohet përdorimit të fjalive pyetëse në kontekste të caktuara ose nënklasifikimit të fjalive nxitëse në ato që shprehin urdhra dhe ato që shprehin këshilla, lejim etj. Nëse njësia gjuhësore është fjali nxitëse ose pyetëse, përcaktohet nga tiparet e saj morfosintaksore, nëse realizon apo jo aktet e caktuara ligjërimore, kjo përcaktohet nga konteksti, për këtë arsye duhen dalluar në terminologji: fjalia nxitëse dhe urdhri, komanda dhe këshilla, lutja etj.

Kjo terminologji do të bënte të mundur, që, ashtu si në gramatikat e gjuhëve të tjera, të pranohet që një pyetje realizohet edhe me një fjali dëftore etj.

### **3. Njohja e fjalive thirrmore si tip i veçantë**

Fjalitë thirrmore duhen njohur si tip i veçantë dhe jo si nënklasë e tipave kryesorë, sepse shqipja ka mjete të veçanta të cilat shërbejnë për të dalluar qartë strukturën sintaksore të tyre nga struktura sintaksore e fjalive dëftore, dëshirore, nxitëse e pyetëse. Sipas Çelikut, fjalitë thirrmore dallohen jo vetëm nëpërmjet intonacionit të veçantë, por edhe nga përbërja strukturore: shpesh në përbërjen e tyre gjejmë pasthirrma, dhe përemra e ndajfolje pyetëse, të cilat shërbejnë për të shprehur ndjenjat e folësit. Fjalë të tilla qëndrojnë në krye të fjalisë.<sup>55</sup> Në tekstet e arsimit parauniversitar, ashtu si edhe në GA, vëllimi i dytë, sintaksa, përemrat e ndajfoljet pyetëse interpretohen si përemra e ndajfolje thirrmore<sup>56</sup> kur ato përdoren në fjali thirrmore, kategori ose përdorim i cili nuk është njohur te Morfologjia (2002). Çeliku gjithashtu pohon se: *“Fjalitë që e kanë foljen në mënyrën habitore janë përgjithësisht fjali thirrmore”*<sup>57</sup>.

### **4. Nevoja për qëndrime të qarta për klasat e nënklasat e tipave të fjalive dhe përfshirjen e strukturave të caktuara**

<sup>55</sup> Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*. Tiranë: ILAR, f. 288.

<sup>56</sup> ASHSH. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe (Vol. Sintaksa)*. Tiranë: Maluka, f. 127.

<sup>57</sup> Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*. Tiranë: ILAR, f. 288.

Përcaktimi i nënklasave të secilit tip kumtesor të fjalive, bëhet edhe më i qartë nëse ruhen kriteret dhe merren parasysh tiparet që ndajnë rrafshet e studimit. Kjo do të bënte të mundur që *pyetjet retorike* të trajtohen në aspektin sintaksor si *fjali pyetëse*, e jo të shihen si variante të ndërmjetme midis fjalive pyetëse e fjalive dëftore, të interpretohen si *pyetje* në aspektin semantik, dhe si *pohime* në aspektin pragmatik.

### **5. Interpretimi i njësive sipas kriterëve të qarta dhe të verifikueshme**

Në Gramatikën e Akademisë pohohet se “Intonacioni nuk është kriter i qëndrueshëm i vlerësimit të njësisë. Ai herë-herë s’është aq qartësisht i përcaktuar.”,<sup>58</sup> ndaj nuk mund të mbështetemi në një njësi fizike për të dalluar klasat e nënklasat e njësive të gjuhës. Është shumë e vështirë për një nxënës shkollë të përcaktojë tipin e një fjalie sipas intonacionit.

Mendojmë që veç intonacionit, si kriteri i rëndësishëm, i përgjithshëm dhe i verifikueshëm edhe në të shkruar, mund të shërbejë rendi i fjalëve.

### **BIBLIOGRAFI**

- Ambroise, B. (2010). *From speech act theory to pragmatics*. HAL.
- ASHSH. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe* (Vol. Sintaksa). Tiranë: Maluka.
- Cipo, K. (1952). *Sintaksa*. Tiranë: N.I.SH. Shtypshkronjave-Stab. Mihal Duri.
- Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*. Tiranë: ILAR.
- Domi, M. (1969). *Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa*. Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore.
- Halliday, M. (2004). *An introduction to functional grammar*. NewYork: Oxford University Press.
- Hudson, R. (1975). The meaning of questions. *Language*, 51 (1).

---

<sup>58</sup> ASHSH. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe* (Vol. Sintaksa). Tiranë: Maluka, f. 120.

- Konig, E., & Siemund, P. (2007). Speech act distinctions in grammar. Në T. Shopen, *Language typology and syntactic description* (fv. 276-324). New York: Cambridge University Press.
- Lloshi, Xh. (2005). *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*. Tiranë: Albas.
- Memushaj, R. (2002). *Hyrje në gjuhësi*. Tiranë: DITURIA.
- Përnaska, R. (2015). *Gjuhësi... gjuhësore*. Tiranë: Maluka.
- Plangarica, T. (2013). *Hyrje në studimin e kuptimit*. Elbasan: Cikël leksionesh.
- Prifti, S. (1958). *Sintaksa e gjuhës shqipe*. Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore të krahinës socialiste autonome të Kosovës.
- Renzi, L., Salvi, G., & Cardinaletti, A. (2001). *Grande grammatica italiana di consultazione* (Vëll. I & III). Bologna: il Mulino.
- Rrota, J. (2005). *Sintaksi i shqipes*. Shkodër: Botime Franceskane.
- Sheperi, I. D. (1927). *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe (sidomos e toskërishtes)*. Vlorë: Shtypshkronja "Vlora" G. Direttore & C.
- Xhuvani, A. (1938). *Njohunit e para të sintaksës shqipe, pjesa e parë, në "Vepra 1"*, Tiranë, 1980.
- Petro, R., Sula, L., Pepivani, N., Çerpja, A., Jubani, A., Metani, I., *Gjuha shqipe 6*, Albas, Tiranë, 2015.
- Petro, R., Sula, L., Jubani, A., Metani, I., Çerpja, A., Çepani, A., *Gjuha shqipe 9*, Albas, Tiranë, 2018.